

# *RAPORTI VLERESIMIT*

## TE NDIKIMIT NE MJEDIS Per Spitalin Rajonal Vlore



**Vendodhja: Lagjja Partizani, Vlore**

**Subjekti: Spitali Rajonal Vlore , Person Juridik Publik**

**Pergatiti Materialin : VIELF STUDIO shpk**  
Adresa : Blv . Bajram Curri, Pallati nr.1, Apartamenti nr.32, Tirane

**Tirane 2015**

## **PERMBAJTJA**

**1- HYRJE**

**2- PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

**3- PERSHKRIMI I RAJONIT**

**4- VLERESIMI I NDIKIMEVE**

**5- MASAT PER ELEMENIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

**6- PROGRAMI I MONITORIMIT**

**7- PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE**

## 1-HYRJE

Mjedisi është bashkësia e nderveprimeve të perberësve biotike dhe jobiotike që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, tokës, ujërave shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgiminë kulturore. Pra mjedisi është një bashkëveprim i faktoreve natyror dhe shoqëror. Faktoret natyror dhe shoqëror të mjedisit ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e njeriut. Për të mbijetuar kohës njeriut i është dashur të përshtatet mjedisit ku jeton dhe ta ndryshoj atë në mënyrë që ta bëjë të përshtatshëm për veten e vet. Por pikërisht në këto pike shfaqen edhe problemet e para të mjedisit.

Kështu përparimi zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë por nga ana tjetër shfrytëzimi pa kriter i mjedisit, të gjitha këto krijuan dhe problemet e para midis njeriut dhe mjedisit. Zhvillimi i teknologjisë bëri që vertet jeta të përmirësohet dhe njerezit të jetojnë më mirë por nga ana tjetër sollin edhe shumë probleme për mjedisin si përsëritja e ajrit, prerja e pyjeve etj.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njerezit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njerezit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore përdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qartë që i perkufizon. Burimet natyrore i referohen burimeve të tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit që rrethon tokën, çdo gjë që rritet në tokë apo det si dhe burimet që gjenden nëntokë si p.sh. mineralet. Mjedisi është me gjithpërfshirës çdo gjë që na rrethon. Zhvillimi i njerezimit dhe i industrisë është shoqëruar edhe me pasojat në mjedis, përqindja e dioksidit të karbonit në atmosferë është rritur rreth tridhjetë përqind që nga fillimi i Revolucionit Industrial.

Thjesht duke përdorur burimet natyrore në rrezikojmë në mbipërdorimin dhe shpërrimin e tyre. Shpërrimi i burimeve natyrore është një nga problemet thelbësore të çrregullimit të mjedisit. Në të përfshihet shpërrimi i ujit, mineraleve përfshirë dhe lëndët fosile si dhe shumë burime të tjera.

Në mënyrë që të shmangim këto probleme njerezit duhet të mesojë se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqërohet edhe me impakt në mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit të mjedisit natyror nga aktiviteti njerëzor. Kemi dy tipe të impaktit mjedisor

- shpërrimi i burimeve
- ndotja

Impakti mjedisor eshte i lidhur ne menyre te drejtperdrejt edhe me rritjet e numrit te popullsise , kjo e fundit rrit konsumin pra:

Impakti mjedisor = numer popullsie x konsum

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

Hartimi i Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin *e SPITALIT RAJONAL VLORE* perfshin pershkrimin e aktivitetit qe zhvillohet si dhe parashikon ndikimet e mundshme ne mjedis dhe planifikimin e masave zbutese ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit.

### ***1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi***

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijojte kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapan e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit Europian per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin europian te mjedisit. Duke qen se kushtetutat ravijezojne drejtimet e rregullimeve te ardhshme dhe me te hollesishme qe realizohen fillimisht me ligje dhe me pas me akte nenligjore edhe ne rastin e vendit tone Kushtetuta perben nje fillese dhe baze te rendesishme lidhur me rolin qe ka mjedisi per shoqerine dhe shtetit tone. Nisur nga permbajtja e neneve te Kushtetutes lidhur me fushen mjedisore mund te pohojme se fryma e Kushtetutes sone eshte ne perputhje me ate te shume kushtetutave te vendeve te tjera demokratike qe u kushtojne rendesi te nje niveli me te larte disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato ne nivelin e ligjit themelor te shtetit, sic jane e drejta per informimin e qytetareve dhe angazhimi e pergjegjesia per nje mjedis te pershtatshem per te jetuar jo vetem brezat e sotem por edhe ata ne te ardhmen.

- ***VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.***

- *Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”*
- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Ligji nr. 10006 date 23.10.2008 « Per mbrojtjen e Faunes se Eger »*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*

## ***1.2 Profili i subjektit***

Subjekti **SPITALI RAJONAL VLORE** eshte institucion shteteror buxhetor, person juridik publik.

Aktivitetin e tij ky spital e nisi në 1916 kur u ndërtuan godinat që janë dhe sot (pavionet 1 katëshe) gjithsej 4 godina me 50-60 shtretër. Me vendim të qeverisë së përkohëshme të Vlorës te asaj kohe mjeku Ali Mihali emërohet drejtor i përgjithshëm, drejtor i spitalit dhe laboratorit.

Ne vitet ne vazhdim Spitali i Vlores pati nje zhvillim akoma me te madh si ne kapacitetin e shtreterve ashtu edhe ne hapjen e reparteve te reja. Ne kete spital kane punuar dhe mjeke te huaj gjate pushtimit italian. Ne vitin 1931 mjeku shqiptar Vasil Dhimitri, drejtor deri më 1944 hap repartin e radiologjisë. Në 1945 Spitali i Vlorës kishte 160 shtretër.

Funksiononin gjithashtu Laboratori, Radiologjia dhe Farmacia. Poliklinika e parë hapet pranë tregut të sotëm në një godinë 2 katëshe. Hapen dhe shtreter per ORL-Okulistikën dhe në 1946 spitali kishte 94 punonjës, 35 ishin infermierë, Drejtor dr. Mihal Angjeli, kapaciteti 245 shtretër, duke shtuar 10 shtretër për otojatërin dhe 45 për infektivin.

Me plotë gojën mund të themi se Dr. Ali Mihali është ndër themeluesit e Spitalit Civil të Vlorës, ndër mjekët koloz të shërbimit të patologjisë që hodhi themelet e mjekësisë bashkëkohore.

Ai hodhi themelet e statistikës mjekësore, këtë ai ia trashëgoi edhe të bijës. Ai themeloi shërbimin neuro-psikiatrik. Këtë profesion ia trashëgoi djalit, Mehmet Mihalit. Deri në vitin 1974 spitali ka funksionuar në godinat e vjetra. Në vitin 1974 ndërtohet godina e re, e cila funksionon edhe sot me shërbime dhe infrastrukturën më të mirë të kohës, me një numër shtretërish 370, duke iu përgjigjur rritjes së popullsisë.

Në spital, gjithashtu, funksionon reparti i imazherisë , laboratorit, reparti i pediatriisë, reparti i kirurgjisë, ORL-Okulistikë, kirurgji maksilo-faciale, patologjia, shërbimi infektiv, dispanceria, dhe shtëpia e lindjes. Në periudhën 1945 – 1990 spitali ka funksionuar me gjithë specialitetet, me një numër mjekësh gjithmonë në rritje.

Aktualisht Znj. Brunilda Mersini që prej muajit Shkurt 2014 drejton Spitalin Rajonal Vlore, në postin e drejtores se ketij institucioni. Ka mbi 20 vjet pune si mjeke prane Spitalit Rajonal Vlore.

## **2- PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### ***2.1 Qellimi i zhvillimit te aktivitetit***

Qellimi i ketij aktiviteti eshte ofrimi i sherbimeve spitalore per te permiresuar shendetin duke ju gjendur sa me prane per te gjithë popullsinë ne rajonin e Vlores dhe jo vetem. Sherbimi shendetesor i ofrohet gjithë komunitetit me mjeket specialist te ketij spitali.

Vizioni I ketij spitali eshte rritja e besueshmerise se komunitetit, permiresimi i sherbimit shendetesor si dhe zhvillimi, vleresimi dhe perdorimi i teknikave te reja nga nje staf me vlera te larta mjekesore dhe shkencore.

### **Objektivat e zhvillimit te aktivitetit**

- 1- Permiresimi i mbjenteve spitalore dhe pajisja me aparatura te reja ne sherbim te komunitetit.
- 2-Zbatimin e protokolleve te mjekimit dhe kodit te etikes.
- 3-Kualifikimin profesional te personelit mjekesor.
- 4-Zgjerimin e games se sherbimeve ne spital duke arritur standartet europiane.

Sherbimet spitalore qe ofrohen jane :

Shërbimi i imazherisë  
 Laboratori klinik  
 Shërbimi i kirurgjisë  
 Kirurgji e përgjithëshme  
 Urologji – Endoskopi  
 Ortopedi – Traumatologji  
 ORL – Okulistike  
 Kirurgji maksilo-faciale  
 Shërbimi i patologjisë  
 Kardiologji  
 Pneumologji – Alergologji  
 Gastrohepatologji  
 Nefrologji  
 Endokrinologji  
 Neurologji  
 Reumatologji  
 Hematologji  
 Shërbimi i reanimacionit  
 Shërbim Obstetrik gjinekologji  
 Patologji infektive  
 Banka e gjakut

Spitali ka rreth 100 mjekë e 320 infermierë të lartë dhe është i organizuar në 370 shtretër të cilët ndahen si më poshtë:

*Pedriatria – 50 shtretër*

*Kirurgjia – 45 shtretër*

*Patologjia – 80 shtretër*

*Infektivi – 30 shtretër*

*Orl – Okulistika – 10 shtretër*

*Shtëpia e lindjes – 85 shtretër*

*Reanimacioni – 12 shtretër*

Gjate viteve te zhvillimit te aktivitetit si dhe ne vitet ne vazhdim te funksionimit te spitalit, ky aktivitet do te jete konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqes nje informacion te shkurter te aktivitetit ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marr per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrojtjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

## **2.2 Vendodhja e projektit**

Spitali Rajonal Vlore ndodhet ne Lagjjen Partizani, Vlore.

Spitali ploteson te gjitha kushtet higjenosanitare.

Furnizimi me uje sigurohet nga rrjeti ujesjelles Vlore ne baze te kontrates se lidhur, uji i pusit perdoret per ujitjen e lulishtes se spitalit.

Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti i zones ne rast te mungeses se saj vihet ne pune gjeneratori. Funksonon sistemi i ventilimit dhe ngrohjes se ambjenteteve spitalore, me kaldaj lenda djegese solar , e cila sigurohet nga shoqeria e kontraktuar ne baze te kontrates qe spitali ka lidhur.

Jane marr masat per mbrojtjen nga zjarri. Ne vende te dukshme jane te instaluar hidrantet si dhe funksionojn daljet emergjente.

Nga ana e personelit jane marr masat per parandalimin dhe mbrojtjen nga infeksionet spitalore.

Shkallet midis kateve dhe koridoret kane hapësira te mjaftueshme per levizje pa probleme.

Spitali eshte i pajisur me ndricim te pershtatshem per te gjitha ambjentet si dhe funksionon sistemi i ventilimit te ajrit te fresket ne dhomat e pacienteve si dhe ne ambjentet e tjera te spitalit.

Mobiljet dhe pajisjet jane te krijuara dhe ndertuara per te thjeshtesuar pastrimin e tyre si dhe lehtesi perdorimi.

Spitali ploteson te gjitha kriteret e ushtrimit te veprimtarise sipas rregullave dhe legjislacionit ne fuqi.

### **Kriteret per personelin mjekesor**

Spitali siguron se personeli mjekesor dhe jo mjekesor ka arsmin dhe kualifikimet e nevojshme sipas vendit te punes qe ushtron. Spitali ka rregullore te brendshme ku percaktohen detyrat dhe pergjegjesit e sicilit punonjes sipas vendit te punes qe ushtron.

### **Repartet ne spitalin Rajonal Vlore jane;**

#### **1- Banka e gjakut**

Çdo ditë spitalit të Vlores i duhen njësi gjaku për transfuzione dhe ndërhyrje kirurgjikale. Sezoni turistik është koha kur nevojat për gjak rriten për shkak të aksidenteve dhe dhurimet ulen, si pasojë e pushimeve. Ndaj eshte e rendesishme qe cdo qytetar ti bashkohet nismes per të dhuruar gjak, pranë bankës së gjakut në Spitalin Rajonal Vlore. Fëmijët talasemikë dhe të rritur të prekur nga anemia mesdhetare, kanë nevojë për gjak që të qëndrojnë në jetë. Dhjetra të aksidentuar, që operohen në spital kanë nevojë për njësi gjaku.



## 2- Kirurgjia

Reparti i terapise intensive ofron nje sherbim te specializuar, cilesor te urgjencave te ndryshme. Perfshihen urgjenca kirurgjikale, operacione te planifikuara , politrauma, urgjenca : abdominale, kranio-cerebrale, te extremiteteve, fraktura, semundje cerebrovasculare te renda , koma , infarkte, shock kardiogjen , crregullime ritmi, patologji infektive te renda ,intoxikacione suicidole forma te renda , patologji pulmonare soturim te ulet O2 , respracion te drejtuar, obs-gjinekologjike forma te renda, djegia forma te renda etj

Reparti i kirurgjise dhe reanimacionit funksionon me 40 shtreter. Ushtrone aktivitetin 6 kirurge te pergjithshem, 3 ortopede dhe 5 reanimatore. Me nje aktivitet rreth 1500 operacione te natyrave te ndryshme: apendicite, hernie, laparocela, colecysta, tumore te traktit digjestiv dhe urgjenca te te gjitha natyrave.

## 3- Laboratori

Laboratori i Spitalit Rajonal Vlore eshte njesi e rendesishme funksionale ne aktivitetin ekzaminues, diagnostikues dhe trajtimin e patologjive te ndryshme.

Aktiviteti i laboratorit konsiston ne nje numer te madh ekzaminimesh qe ky laborator kryhen ne sherbim te komunitetit.

Gjate vitit 2014 per here te pare ne Laboratorin e Spitalit Rajonal Vlore jane vene ne pune aparatura te standarteve te larta bashkekohore.

## 4- Materniteti

Reparti I Maternitetit funksionon brenda spitalit me 80 shtretër . Ushtrone aktivitetin e tyre 10 mjekë obstetër – gjinekologë. Priten rreth 1500 lindje në vit. Funksionon salla e operacionit për operacione gjinekologjike dhe obstetrikale si: kiste, fibromioma, sexio etj.

### *Urgjenca gjinekologjike*

Operacionet bëhen me laparatomi. Funksionon shërbimi i Kolposkopisë, ECHO-Grafi për moshën e barrës, fluximetria, percaktim seksi dhe profili biomterik. Shërbimi i neonatologjisë I lidhur ngushtë me obstetrikën, me një reanimacion të mirëpajisur me aparatura bashkohore dhe staf me shumë përvojë. Në të ushtrojnë aktivitetin 5 mjekë.

## 5- Orl- okulistike

Kryhen operacione te natyrave te ndryshme – tonsilektomi – adenektomi – deviation septinazi, plastika te veshit dhe traumat, trupat e huaj ne rruget e frymemarrjes. Okulistet realizojne operacione te kataraktit me lente me metoden klasike dhe FACO.

## 6- Ortopedia

Ne spital realizohen te gjitha operacionet e traumes te shkalles dhe veshtiresise se larte. Reanimacioni: Funksonon me 12 shtreter si reanimacion polivalent. Ushtrojne aktivitetin e tyre 5 mjekë anesteziologe – reanimator

## 7- Patologjia

Reparti i sherbimit te Patologjise Ofron

- Konsultat me mjeket specialist per pacientet e hospitalizuar shtrimet e reja
- Vizitat e pacienteve te hospitalizuar.
- Ekografi kardiake per pacientet ambulatory me rekomandim nga mjeku specialist I Poliklinikes Qendrore.

Ushtrojnë aktivitetin këto shërbime në 80 shtretër

- **Kardiologjia**
- **Neurologjia**
- **Endokrinologjia**
- **Pneumologjia dhe Alergologjia**
- **Nefrologjia**
- **Hematologjia**
- **Reumatologjia**
- **Fizioterapia**
- **Toksikologjia**
- **Gastroenterologjia**

## 8- Pedriatia

Pedriatia funksionon me 45 shtretër si pediatri e përgjithëshme dhe 12 shtretër si pediatri infektive. Në këtë repart punojnë 10 mjekë pediatër me nenspecialitete:

- Reanimacion pediatrik
- Pediatër alergolog

- Peditër nefrolog
- Peditër infeksionist
- Peditër hematolog
- Peditër i përgjithshëm

## 9- Urgjenca

Krijimi i repartit të urgjencës është prioriteti i punës për përfitimin e kapaciteteve operacionale të ekipit mjekësor për të nderhyrë në kohë për pacientet me sëmundje akute.

Urgjenca e Spitalit Rajonal Vlorë sot ka katër dhoma për pacientet ku risi ka qenë dhoma e reanimacionit me 4 shtretër të ndarë me bokse për të ruajtur privatesinë e pacientëve. Brenda ambienteve ndodhet dhoma e infermiereve që monitorojnë të sëmurët, dhoma e kryeinfermierit, dhoma e mjekut roje.

Janë gjithsej 15 shtretër në dispozicion të pacientëve dhe shfrytëzimi i tyre është maksimal duke patur mundësinë të përballojë dhe 2 -fishin e fluksit të mëparshëm në kushte më të mira.

## 3- PERSHKRIMI I RAJONIT

**3.1 Vlores** është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë. Vlores është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit, me një popullsi afërsisht 200,000 banorë. Ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, në Detin Adriatik.

### 3.2 Kushtet klimatike

Klima e Rajonit është tipike mesdhetare me një dimër të lagësht dhe të ngrohtë dhe me një verë të nxehtë e cila arrijn deri në 40 gradë. Në përgjithësi në rrethin e Vlores, regjimi i presionit të ulet zgjat pak dhe periudha me kohë të mirë është me të gjatë se në pjesët e tjera të vendit. Faktorët që përcaktojnë klimën e kësaj zone janë:

- Pozicioni gjeografik dhe afërsia me detin që zbut efektet ekstreme të klimës.
- Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që rregullojnë klimën e krejt rajonit.
- Larmia e formave të relievit dhe drejtimi i përcaktuar mirë i vargmaleve dhe luginave.

Temperaturat mesatare për Vloren ndryshojnë nga 16,1 në 17,7 gradë. Në Vlores mungojnë temperaturat e uleta që regjistrohen në zonat e tjera të vendit. Temperaturat me të uleta, si në të gjithë zonën bregdetare të Shqipërisë, regjistrohen gjatë Janarit-Shkurtit.

Sasia mesatare e reshjeve arrijn 1200mm/vit, pjesa më e madhe e të cilave në nëntor-dhjetor. Muajt me të thatë janë Korriku, Gushti dhe Shtatori. Deti dhe format e relievit ndikojnë shumë në shpërndarjen e reshjeve në rrethin e Vlores. Luginat e Shushicës, Dukatit, Borshit e Vjosës

sherbejne gjate gjithë vitit si zona te shkembimit klimaterik te zonave te bregdetit me ato ne brendesi. Kjo eshte arsyeja e shirave te bollshme prane zonave malore ne krahasim me zonat e tjera te rrethit. Ndersa ne zonen bregdetare te qytetit sasia mesatare e reshjeve eshte 1000mm/vit e ne Orikum 1314mm/vit, ne zonat malore si Llogara e Dukat, reshjet arrijne perkatesisht 2500 e 2453mm/vit. Numri mesatar i diteve me lageshti eshte 105 - 147dite ne vit. Debora eshte nje dukuri teper e rralle ne bregdet, ndersa ne zonat malore eshte nje dukuri normale qe fillon qe ne nentor. Pozicioni gjeografik i rrethit te Vlores ben qe zona te jete nen ndikimin e ererave te fuqishme, qe jane te ndryshme per nga forca dhe prania gjate vitit. Erera te zakonshme jane puhite detare, te cilat ndihen me shume gjate bregdetit. Rajoni i Vlores ne pergjithesi dallohet per ererat e forta, kjo per shkak te konfigurimit te relievit dhe gjirit te Vlores.

### 3.3 Gjeologjia

Rajoni i Vlores i takon zonës paleogjeografike jonike, e cila në përdim kufizohet me zonën e Sazanit dhe në lindje me zonën e Krujës. Një njësi e veçantë, më e re se të parat, është ultësira pranadriatike që mbivendoset mbi të tria zonat e lartpërmendura. Zona jonike gjatë zhvillimit të vet paleogjeografik ka qenë një basen detar i thelle nga jorasiku në paleogjen, kurse dy zonat fqinje, Sazani dhe Kruja, kanë qenë basene detare të cekta, shpesh të dala dhe mbi ujë.

Në fillim të miocenit të mesëm, rreth 15 milion vjet më parë, zona jonike u përfshi nga proceset e rrudhosjes dhe të malformimit, duke u shndërruar dalëngadalë në stere. Në këtë kohë u formuan disa breza të rrudhosur mbiujorë me pamje antiklinale, si brezi antiklinal i Çikës, ai i Kurveleshit, etj.

Midis tyre mbeten breza nënujore në trajtë sinklinale, si ai i Shushicës, ku vendoset edhe Kuçi, Memaliajt etj. Në fund të miocenit, rreth 5 milion vjet më parë, ndodhi një rrudhosje tepër e fuqishme, që e shndërroi ultësirën pranëadriatike në strere me mjaft rrudha antiklinale e sinklinale.

**Zona Jonike** - eshte zona kryesore nafte - gazmbajtese e Shqiperise. Perfaqeson nje platforme te gjere me evaporite dhe karbonate te ujrave te cekta gjate Triasikut deri ne fillim te Liasikut dhe

trog me sedimente pelagjike karbonatike e silicore deri ne Eocen te vonshem. Flishi depozitohet gjate Oligocenit dhe Miocenit te hershem. Gjate branisjes mbi zonen Sazani dhe zonen e Adriatikut Jugor ne fund te Miocenit dhe me vone ajo eshte e ndare ne mikrobloqe dhe luspa te trasha kryesisht me baze evaporitet triasike.

- **Nenzona e Çikes** - shtrihet ne pjesen perendimore te zones Jonike. Karakteristike e prerjes ne nenzonen e Çikes eshte prania e gelqeroreve algore te Liasikut te poshtem, amonitikut te kuq te Toarianit, mungeses se pakos se poshteme silicore dhe pushimeve te tjera nenujore. Flishi ka trashesi te reduktuar. Ne nenzonen e Çikes veçohen nje sere strukturash te rrudhosura si vargu antiklinal Bogaz – Çike - Tragjas, sinklinali i Dukatit etj.

- *Nenzona e Kurveleshit* – shtrihet ne pjesen qendrore te zones Jonike dhe perfaqeson pjesen me te thelluar te saj. Ndertohet nga disa vargje strukturore antiklinal-sinklinal. Eshte zona me me perspektive per nafte dhe gaz.

### 3.4 Flora dhe fauna

Mbulesa bimore e rajonit është dëmtuar shumë nga shpyllëzimet për toka bujqësore (bukë), nga prerjet për dru zjarri, djegiet e bëra nga barinjte dhe nga kullotja pa kriter e bagëtisë (dhive). Bimësia më e përhapur janë shkurret e tipit mesdhetar (makja) të përbëra nga : sqina (xina), koçimarja, përralli, mersina, shqopa, cfaka (bezga), thrumja, sherebeli etj. Në luginat përhapje të gjerë ka dhe hilqja dhe rrapit. Në pjesët e larta rritet bredhi e pak pisha. Ka gjithashtu kullota të pasura verore.

### *Kafshe e egra*

Nga kafshët e egra më shumë gjendet derri i egër dhe lepuri, të dëmtuar rëndë nga gjuetia. Haset edhe dhelpa, kunadhja, dreri (sorkadhja) gjendet ne pyllin e

mbrekullueshem te Zarelit si dhe ne pjesen e poshtme te fshatit si ne Shen Thanas, Perroi i Thate etj, shqarthe (macja e eger), lunderza (vidhra) ne lumin Shushice. Nga shpendët përhapje), kukumjaçka (bufi), qyqja, si dhe harabeli, gushkuqi dhe lloje të ndryshme shpendësh. Ne lumin e Shushicës gjenden me shumice trofta, ndërsa ne përrenjtë qe derdhen ne lume ka shume krap te madhësive te vogla, si dhe ngjala. Ne terrenin me shkurre ka zvarranike te përmasave dhe llojeve te ndryshme, te pastuduara ende. Ka gjarpërinj me madhësi edhe mbi 2 merta, ndodhen gjithashtu edhe nepërka nje gjarpër i rrezikshëm sulmues, astiti dhe gjarpërinj me ngjyra e madhësi te ndryshme. Ne te gjitha pyjet me shkurre te bie ne sy një numër i madh breshkash.

### 3.5 Rrjeti hidrike dhe ujerat

Uji eshte nje pasuri natyrore me vlera te medha kombetare. Ai ka perdorim te madh ne bujqesi, ne industri dhe per furnizimin e qendrave te banuara. Rajoni i Vlores eshte nje rajon bregdetar i cili laget nga deti Adriatik edhe ai Jon, Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lumi i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Por rajoni eshte i pasur edhe me burime ujore , zona e Kuçit ka pasuri të shumta ujërash, si pak fshatra të Kurveleshit ku numërohen rreth 157 burime ujore. Pasuritë më të mëdha janë burimet e Lëpushës me 550 l/s, dhe buronjat e Kuçe me 300 l/s ; një nga burimet më të mëdha karstike të Shqipërisë jugore. Buronjat e Kuçe shkarkojnë ujërat nëntokësore që grumbullohen në masivin karstik të Kurveleshit të Sipërm, i cili gjendet rreth 600 m më lartë se vendi ku dalin Buronjat. Buronjat përfaqësojnë një objekt me rëndësi turistike për gjithë rajonin.

#### 4- VLERESIMI I NDIKIMEVE

*Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve ne mjedis*

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e me poshteme:

- Njohja me aktivitetin
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti
- Njohja me infrastrukturen egzistuese

Duke njohur zhvillimin e aktivitetit u indentifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit .

**Identifikimi i ndikimeve** – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-aktivitet dhe u indentifikuan ndikimet e mundeshme gjate fazes qe zhvillohet aktiviteti sipas receptoreve te mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe parafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis aktivitetit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

*- shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuar ( Shkalla)*

**Shtrirja fizike-** Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).

**-Kthyesmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar )

**-Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

#### *Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve*

Zhvillimi i aktivitetit spitalor nuk ka ndikime negative mbi shendetin e tyre , ky aktivitetet me sherbimet qe ofron ju vjen ne ndihme per nevojat shendetesore qe popullsia e rajonit ka.

#### *Ndikimet ne toke*

Per mbetjet spitalore qe krijohen nga zhvillimi i aktivitetit eshte kontraktuar firme private per trajtimin e tyre. Mbetjet urbane qe krijohen nga aktiviteti i perditshem i personelit

grumbullohen ne kontenieret perkates dhe me pas largohen nga firmat e kontraktuar nga Bashkia Vlore per largimin e mbetjeve urbane te qytetit.

#### ***Ndikimet ne uje***

Nuk do te kemi shkarkime ne mjedisin ujqor prites te cilat mund te ndryshojne cilesine e ujerave nentokesor apo siperfaqesore. Uji qe perdoret nga stafi per nevoja higjenosanitare do sigurohet nga rrjeti i zones.

#### ***Ndikimet ne ajer***

Kaldaja qe perdoret per ngrohje punon me solar , furnizimi i depozitave behet nga firma e cila eshte kontraktuar oxhaku ka nje lartesi 25 metra eshte i pajisur me filtra per eliminimin e emetive ne gazeve ne atmosfere.

#### ***Ndikimet nga zhurmat***

Vet aktiviteti kerkon nje ambjent te qete pa zhurma duke qen se ka te bej me trajtimin e pacienteve te semure. Te vetmet zhurma qe mund te krijohen jane nga sirenat e autombulancave ne rastet urgjente te transportimit te te semureve.

#### ***Ndikimet ne flore dhe faune***

Ky aktivitet nuk sjell shkaterrim te rendesishem te habitateve natyrore. Zona paraqitet me nje flore dhe faune jo shume te pasur.

#### ***Ndikimet ne klime***

Gjate zhvillimit te projektit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj.

#### ***Ndikime mbi trashegimine kulturore***

Zona ku ushtron aktivitetin spitali nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor.

#### ***Ndikimet me natyre nderkufitare***

Zhvillimi i aktivitetit ndodhet brenda territorit te vendit tone dhe nuk ka ndikime me natyre nderkufitare.

## **5. MASAT QE DUHEN MARR PER ELEMINIMIN / MINIMIZIMIN E NDOTJEVE**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate zhvillimit te aktivitetit.

### ***Masat per emetimet ne ajer***

Oxhaku i kaldajes eshte i pajisur me filtra per eleminimin e gazeve qe dalin djegia e lendes djegese. Filtrat do te monitorohen ne menyre periodike dhe do te nderrohen ne rastet kur jane te demtuar ose nuk jane ne mirefunksion.

### ***Masat per Shkarkimet ne uje***

Uji qe perdoret per nevojat vetjake nga personeli i spitalit si dhe pacientet sigurohet nga ujesjellesi Vlore, nuk permban elemente ndotes per mjedisin uJOR prites. Ky uje i bashkohet rrjetit te kanalizimeve te qytetit.

### ***Masat per Depozitimet ne toke***

Mbetjet spitalore ruhen ne magazine te vecante derisa terhiqen nga firma e kontraktuar. Koha mesatare e qendrimit eshte 8 dite. Mbetjet urbane terhiqen nga shoqeria e kontraktuar nga Bashkia Vlore per largimin e mbetjeve urbane te qytetit.

### ***Masat ndaj zjarrit***

Rreziku ndaj zjarrit eshte prezent ne te gjitha mjediset, zjarri eshte nje djegie qe zhvillohet ne menyre te pakontrolluar ne kohe dhe hapesire , pra eshte nje reaksion kimik ndermjet nje trupi te djegshem dhe nje trupi qe djeg. Per te ulur shkallen e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e spitali jane marr masat ndaj mbrojtjes se zjarrit. Hidrantet vendosen ne zona te dukshme dhe punonjesit do te instruktohen per perdorimin e tyre ne raste aksidentesh.

### ***Masat ndaj zhurmave***

Burim zhurme është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, që lëshon zhurmë. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi. Sirenat e autombulancave gjate transportimit te pacienteve te semure ne rastet urgjente jane te pashmangshme por duke qen se operojne ne intervale kohore te shkurtera nuk perbejn prolem shqetesues.



### *Masat estetike dhe ekologjike*

Masat estetike dhe ekologjike konsistojne ne rregullimin e ambientit te jashtem me lule dekorative per te krijuar nje ambient te kenaqshem per syrin e njeriut. Ne perimetrin perreth spitalit si dhe ne sheshin ku eshte edhe hyrja kryesore eshte krijuar ambient i gjelber per te cilin tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e tij.

## **6. PROGRAMI I MONITORIMIT**

Monitorimi i mjedisit eshte sistemi i mbikqyrjes dhe studimit te kushteve mjedisore. Monitorimi perfshin marrjen e mostrave ne ajer, toke, uje per te percaktuar nese ndonje faktore fizik apo biologjik ndikon negativisht ne ekosistemet apo habitatet natyrore. Monitorimi eshte proces qe realizohet per te mbrojtur mjedisin dhe shendetin e njerezve.

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Bazuar ne kuadrin ligjor ekzistues te gjithë aktivitetet te cilet veprojne ne mjedis monitorohen persa i perket ndikimit qe ato kane ne mjedis. Ky monitorim behet ne menyre qe te nxjerrim konkluzione sa me te sakta per te kryer nderhyrjet e nevojshme.

## **7. PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE**

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane zgjidhur duke kontraktuar shoqeri te cilat merrren me terheqjen e mbetjeve spitalore dhe trajtimin e metejshem te tyre. . Mbetjet urbane qe krijohen nga aktiviteti i perditshem i personelit hidhen ne vendin e caktuar per kete qellim dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga Bashkia Vlore.

Grumbullimi i mbetjeve ne magazina te vencanta deri ne momentin e terheqjes nga shoqeria e kontraktuar eshte pergjegjesi e spitalit.

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, spitali Rajonal Vlore nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie te mira me publikun dhe ambientalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.